

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT AKADEMIK DHE KURRIKULËS

Nr. 4030 Prot.

Tiranë, më 08.11.2022

**Lënda:** Përcillet për zbatim Vendimi nr. 84, datë 08.11.2022 "Për miratimin e hapjes së sezonit të posaçëm në muajin nëntor 2022" të Senatit Akademik të UMT-së

FAKULTETIT TË MJEKËSISË  
FAKULTETIT TË SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE  
FAKULTETIT TË MJEKËSISË DENTARE ✓

Këtu

Bazuar në ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin...", Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, bashkëlidhur ju dërgojmë për zbatim Vendimin nr. 84, datë 08.11.2022 "Për miratimin e hapjes së sezonit të posaçëm në muajin nëntor 2022", të Senatit Akademik të UMT-së.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

REKTOR  
Arben GJATA





UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

WWW.UMED.EDU.AL



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 4028 / Prot. 1

Tiranë, më 08.11 .2022

VENDIM

Nr. 84, datë 08.11 .2022

**“PËR MIRATIMIN E HAPJES SË SEZONIT TË POSAÇËM NË MUAJIN NËNTOR”**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, neni 138, pas shqyrtimit të propozimeve të njësive kryesore të UMT, nr.2287/1 prot., datë 02.11.2022 (FM), nr.636/1 prot., datë 03.11.2022 (FMD), nr.1383/2 prot., datë 25.10.2022 (FSHMT), si dhe në vijim të mbledhjes së datës 07.11.2022 të Rektoratit të UMT, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë

VENDOSI:

- I. Të miratojë hapjen e sezonit të posaçëm në muajin nëntor 2022, në tre njësitë kryesore të UMT.
- II. Studentët, të cilët nuk plotësojnë kreditet për të kaluar në vitin pasardhës, kanë të drejtën e hyrjes deri në dy (2) provime.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet njësive kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

KRYETARI

Prof. Dr. ARBEN GJATA

